Integrimi gjinor

Është (ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve politike, ne mënyrë që perspektiva gjinore të mishërohet ne të gjitha politikat e të gjitha niveleve dhe shkalleve prej akterëve të përfshirë ne politik-bërje.

Integrimi gjinor do të thotë që barazia gjinore të bëhet pjesë e plot e politikave të zakonshme. Ajo nënkupton një përkufizim me të gjerë dhe me përfshirës të barazisë gjinore, duke i dhënë vlerë ndryshimeve dhe larmisë.

Një qëndrim më i përgjithshëm favorizon punësimin e grave, sidomos në institucionet tashmë të "përcaktuara" si profesione femërore, të tilla si mësimdhënëse, shitëse, mirëmbajtëse etj.

Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore"

Active CITIZENSHIP KOSOVA

Kjo fletëpalosje ka për qëllim informimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve, në veçanti grave dhe bizneseve, mbi rendësin e punësimit të grave dhe respektimit të ligjit për barazi gjinore.

Grupi jo formal dhe formal i grave, gratë asmbeliste, gratë aktive në komunitet dhe Zyra për Barazi Gjinore në Rahovec kanë bërë të mundur realizimin e kësaj fletëpalosje për të lehtësuar qasjen dhe informimin e qytetarëve, konkretisht grave mbi të drejtat e tyre, dhe bizneseve mbi respektimin e ligjit të punës dhe ligjit për barazi gjinore.

Fletëpalosja ka dalë si nevojë nga aktivitetet e grupeve të grave në kuadër të iniciativës " Fuqizimi i gruas përmes punësimit" e cila realizohet nga grupi jo formal i grave, grat asambeliste dhe Zyra për Barazi Gjinore Rahovec, që realizohet në kuadër të programit " Qytetari Aktive" të realizuar nga Syri i Vizionit me mbështetje financiare nga Olof Palme Internacional Center dhe SIDA.

Syri i Vizionit

OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER

FUQIZIMI I GRUAS PËRMES PUNËSIMIT



Në një shoqëri si e jona, e cila akoma nuk ka gjetur ekuilibrin e duhur, të jetë model pozitiv, e aq më tepër një grua e suksesshme në vendimmarrje apo në jetën publike, është një sfidë, aspak e lehtë.

Shoqëria tradicionale, i sheh ato në rolin e nënës, mësueses, gruas. Por pjesëmarrja dhe kontributi i tyre, gjithmonë e më i njohur, gjithnjë e më formal, shtrihet në çdo pjesë të jetës. Sa më shumë të bëhen prezent, gratë në rolet e ashtuquajtura jo-tradicionale, aq më shume ndikim krijojnë, aq më shumë kreativitet, vlerë, praktikë dhe energji sjellin ato.

Gratë nuk janë, nuk kanë sesi të jenë thjesht një numër – diçka më shumë apo më pak se gjysma e popullsisë. Ato luajnë role kyçe në formësimin e jetës sonë, zhvillimin e ekonomisë sonë.

Garantimi i të drejtave dhe mundësive të barabarta

Shteti, i garanton të drejtat e barabarta me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet në fuqi. Megjithatë, në praktikë është shumë më sfiduese për gratë që t'i gëzojnë dhe t'i ushtrojnë këto të drejta. Niveli i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe pozita e tyre ne shoqëri, varet kryesisht nga pozita ekonomike që ato kanë. Një prej vlerave më të rëndësishme të gjinisë femërore, është ajo e përtëritjes së shoqërisë njerëzore, vlerë e cila e ka vënë atë në një pozicion jo shpesh të lakmueshme për të arritur zhvillimin e saj individual në raport me karrierën.

Andaj, çdo shoqëri ka për detyrë të krijojë mekanizma për të lehtësuar krijimin e një baraspeshe, ne mes të përtëritjes së jetës dhe krijimit të karrierës si vlera të padiskutueshme. Ligji për pushimin e lindjes, shihet si një instrument i rëndësishëm për të ndihmuar gruan në karrierë, që të mund të arrijnë një qetësi mendore dhe fizike në kohën para dhe pas lindjes. Respektimi i këtij ligji nga institucionet shtetërore dhe ato private, duhet të bëhet kërkesë e domosdoshme për tu realizuar. Çdo qytetar është i barabartë para ligjit, dhe çdo institucion duhet të respektojë ligjin në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminime.

Barazi gjinore

Barazia gjinore nuk nënkupton luftë gjinore për dominim, përkundrazi ka për qëllim promovimin e vlerave gjinore dhe përdorimin e këtyre vlerave në zhvillimin individual dhe atë shoqëror. Duke qenë se kontributi i çdo gjinie është i patjetërsueshëm, atëherë nuk është e drejtë e askujt qoftë në nivelin individual dhe atë institucional, të shkelë këtë të drejtë e cila është e mbrojtur edhe me ligj.

Barazia Gjinore është një parim sipas të cilit, të gjitha qeniet njerëzore pa dallim race, seksi, bindjeje fetare, niveli social-kulturor apo status politik duhet të kenë të drejta ligjore të barabarta.

Drejtësia gjinore: Merret me promovimin e barazisë personale, shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë. Ky term lindi nga të kuptuarit gjithnjë e me shumë të padrejtësive ne shoqëri. Traditat vazhduese te koncepteve, stereotipive dhe praktikave diskriminuese kanë rezultuar ne zhvlerësimin sistematik të qëndrimeve, veprimtarive dhe aftësive që i atribuohen vajzave dhe grave.